



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, merr këtë

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E NËNAVE LEHONA, PËRFITUESE TË SKEMËS SOCIALE

I.

MIRATOHET Vendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të posalindurit e tyre).

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, kjo pako përfshinë të gjitha nënat lehona, përfituese të skemës sociale që kanë lindur fëmijë nga data 01.01.2022 e tutje, do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës në shumën prej 500.00 € (pesëqind euro).

III.

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ua ndanë nënave lehona që së paku pas lindjes të kenë mundësi t'iu sigurojnë shërbimet dhe produktet e nevojshme esenciale për të posalindurit.

IV.

Të gjitha nënat lehona të cilat do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës, duhet të jenë të regjistruara si përfituese të skemës sociale dhe të regjistruara në regjistrat civilë, me adresë të vendbanimit në komunën e Prishtinës.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe drejtoritë tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-450/03-103960/22, më 12.05.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

